



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 316/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Rustem Thaqi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës afër vendvotimeve, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.316/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës afër vendvotimeve, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.316/2019, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar, se nga ana e subjektit politik PDK, është bërë fushatë afër vendvotimeve, respektivisht në shkollën Nazim Gafurri, duke shpërndarë materiale zgjedhore, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me nenin 36 par.1, pika b) të LZP-së, nenin 8 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, dhe nenin 7 të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, duke propozuar që këto veprime të sanksionohen. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë, të datës 07.10.2019, ka theksuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, për arsye se nga fotoja që paraqitësi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, nuk mund të dëshmohet se nga ana e PDK-së janë ndërmarrë veprime të ndaluara, për shkak se fotografia është e paqartë si provë dhe nuk dëshmon në asnjë rrethanë fakte të sakta, duke propozuar që PZAP-i, ta hudhë ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar, për këto arsye:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, Paneli nuk mundi të konstatoj se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur dispozita ligjore e LZP-së, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se paraqitësi i ankesës, ankesës nuk i ka bashkangjitur dëshmi të qarta dhe bindëse për të argumentuar pretendimet e tija, se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). janë shkelur dispozitat e LZP-së dhe rregullave zgjedhore.

Nga fotografitë e bashkangjitura si provë nga paraqitësi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet data, koha dhe as vendi i shkeljes së supozuar. Andaj, Paneli, vlerësoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se në këtë rast ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as e rregullave zgjedhore, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik PDK, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, nenit 117 dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.316/2019 më datën 07.10.2019

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.